

## PLANI FINAL I VEPRIMIT I GRUPIT ZBATUES (GZ) PËR PROTOKOLLIN TEKNIK PËR MIK

### Matrica e zbatimit

Numri i TeR	Veprimi i kërkuar	Pala përgjegjëse	E mbështetur nga	Afati përfundimit i
2.2.1	Palët do të fillojnë me themelimin dhe operimin e 4 PPK-ve atë në Jainjë/Rudnice, Dheu i Bardhë/Konqul, Tabavije/Bërnjak and Merdarë-Merdare. Krijimi dhe funksionalizimi i PK/ZPP në Depce/Muçibabë dhe Mutivodë/Mutivode do të fillohet në një fazë më të vonshme. Pas përfundimit të katër PPK-ve të para do të filloj puna për krijimin e dy PPK-ve tjera, siç edhe është përcaktuar në Protokollin Teknik.			
	Diskutimet për lokacionin e pikë-kalimeve të 'përhershme' të përbashkëta	GZ	NA	Mënyra e përparimit e dakorduar me 04 dhjetor 2012
	GZ për MIK ka propozuar lokacionet për pikë-kalimet e 'përhershme' të përbashkëta. Më 12/13 dhjetor 2012 <sup>1</sup> do të zhvillohen diskutime të mëtejshme. Një projekt zbatues i financuar nga BE do të filloj sapo të konsiderohet se është i arsyeshëm funksionalisht.			
2.2.2	Marr parasysh që nuk ka fonde në dispozicion për financimin e menjëhershëm për realizimin e PK-ve/ZPP-ve, Palët do të hulumtojnë mundësitë për objekte të përkohshme për prezencën e shërbimeve në 4 PK-të e lartpërmendura.			
	Dakordimi për afatin e themelimit të pikë kalimeve të përbashkëta "të përkohshme"	GZ	NA	E dakorduar me 4 dhjetor 2012
	Palët, më 04 Dhjetor 2012, janë pajtuar që pikë kalimet e përbashkëta 'të përkohshme' në Jarinjë/Rudnice dhe Merdarë-Merdare të funksionalizohen plotësisht me 10 Dhjetor 2012, 08.00.  Palët, më 04 Dhjetor 2012, janë pajtuar që pikë kalimet e përbashkëta 'të përkohshme' në Dheu i Bardhë /Konqul, Bërnjak- Tabalije të funksionalizohen plotësisht me 31 Dhjetor 2012, 08.00.			
2.2.3	Palët do të krijojnë mekanizma për qëllim të shkëmbimit të informacionit, inteligjencës dhe të dhënave të tjera, pa paragjykuar ndonjë detyrim që Palët kanë hyrë me BE-në dhe/ose organizata të tjera ndërkombëtare, nga fushat të cilat janë ose mund të jenë relevante për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve kriminale, si dhe për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe sigurisë së ushqimit, në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë. Këto mekanizma do të përfshijë shkëmbimin e statistikave mbi lëvizjen e personave dhe mallrave. BE-ja do të bëjë përpjekje maksimale për të lehtësuar se Palët në GZ do të shkëmbejnë			

<sup>1</sup> Në përputhje me pikën 7 të konkludimeve të dakorduar të MIK, në veçanti me seksionin 2, ky vendim është pa paragjykim ndaj demarkacionit potencial.

	informacion nëpërmjet përdorimit të sistemeve/nismave/projekteve të themeluara nga BE (p.sh. nëpërmjet shkëmbimit sistematik elektronik të të dhënave (SEED, etj.)		
Marrëveshjet për procedurat e shkëmbimit të informacionit	GZ	NA	E dakorduar me 4 dhjetor 2012
<p style="text-align: center;"><b>Procedura e shkëmbimit të informacionit lidhur me funksionimin e ZPP</b></p> <p>Në pajtim me konkludimet e dakorduara nga Dialogu për MIK i datës 02 Dhjetor 2011, veçanërisht me Seksioni E, nenin 35 të Protokollit Teknik për realizimin e MIK, Palët janë dakorduar për procedurat e shkëmbimit, përpunimit dhe përdorimit të informatave, si në vijim:</p> <p><b>Përkufizimet</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) “Të dhënat personale” nënkupton çdo të dhënë në lidhje me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm: një person i identifikueshëm është ai/ajo i/e cili/cila mund të identifikohet, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikues apo një ose më shumë faktorëve të veçantë të tij/saj fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, identitetit kulturor ose shoqëror;</li> <li>2) “përpunimi i të dhënave personale "(këtej e tutje i referuar si" përpunimi") nënkupton çdo veprim ose një sërë veprimesh që kryhen mbi të dhënat personale, qoftë nëpërmjet ose jo mjeteve automatike, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, adaptimi apo ndryshimi, korigjimi , konsultimi, shfrytëzimi, shpalosja nëpërmjet transmetimit, përhapja ose ndryshe vënia në dispozicion, përshtatja ose kombinimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi;</li> <li>3) “Informacioni "nënkupton të dhënat personale dhe jo-personale.</li> </ol> <p><b>A) Parimet themelore</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>(1) Palët do të shkëmbejnë informata relevante, duke përfshirë të dhënat operative dhe personale, me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të aktiviteteve kriminale, si dhe për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve. Shkëmbimi i të dhënave gjithashtu ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe sigurinë e ushqimit në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë. Shkëmbimi i të dhënave përfshin ndarjen e statistikave në lidhje me lëvizjen e personave, automjeteve dhe mallrave dhe statistikave mbi paligjshmëri e zbuluar.</li> <li>(2) Shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave të tjera do të bëhet pa ndonjë paragjykim ndaj ndonjë detyrim që Palët kanë hyrë me BE-në dhe/ose organizatat/subjektet e tjera ndërkombëtare.</li> </ol> <p><b>B) Shkëmbimi i informacionit</b></p>			

	<p>(1) Palët do të shkëmbejnë informacionin e mëposhtëm të rëndësishme për funksionimin normal të "ZPP":</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informojnë njëri-tjetrin për ligjet, rregullat, rregulloret përkatëse dhe informacione të tjera përkatëse për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme, të cilat aplikohen në fushat e tyre të veçanta të përgjegjësisë;</li> <li>• Ndihmojnë njëri-tjetrin në të gjitha fushat që lidhen me çdo lloj të veprimtarisë së paligjshme, penal apo me fjalë tjera aktivitetet e paligjshme në kufi në mes të fushave të tyre të veçanta të përgjegjësisë;</li> <li>• Informacione të rëndësishme për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprimtarive kriminale, sidomos trafikimit me qenie njerëzore, migrimit ilegal, kontrabandës, trafikut të drogës, tregtinë e paligjshme të armëve, eksplozivëve dhe municionit.</li> <li>• Informojnë njëri-tjetrin për të gjitha aktivitetet, rrjedhën e ngjarjeve apo ngjarjet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve në lidhje me aktivitetet e paligjshme përtej kufirit;</li> <li>• Informojnë njëri-tjetrin për problemet dhe emergjencat të cilat ndikojnë në "ZPP", indikacionet e emergjencës në "ZPP", indikacione mbi ngjarjen që ndikon në kontrollin e njerëzve, automjeteve dhe mallrave në "ZPP";</li> <li>• Informojnë njëri-tjetrin në lidhje me mallrat dhe dokumentacionin mbështetës të sinkronizuar reciprokisht për dërgesat, përfshirë certifikatat e origjinës së mallit, si dhe ato që i nënshtrohen ekzaminimit veterinar dhe/ose fitosanitar;</li> <li>• Informojnë njëri-tjetrin për shpërthimin e sëmundjeve ngjitëse veçanërisht ato të rrezikshme të kafshëve, organizmave të dëmshëm në bimë, produkteve bimore dhe objekteve të duhura, si dhe masat që janë marrë për kontrollin dhe çrrënjosjen e tyre;</li> <li>• Informojnë njëri-tjetrin për ushqimin i cili është klasifikuar si i pasigurt;</li> <li>• Lehtësuar nga EULEX-i, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, çdo asistencë e ofruar nga Palët do të kryhet deri në masën e cila lejohet nga ligjet e tyre të veçanta aktualisht të aplikueshme dhe brenda kufizimeve të kompetencave, aftësive dhe burimeve të tyre;</li> </ul> <p><b>C) Procedurat për shkëmbimin e informacionit</b></p> <p>(1) Informatat nga seksioni B do të shkëmbehen vetëm me shkrim me anë të faksit dhe postës elektronike (e-mail), të lehtësuara nga EULEX-i në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij. Të dhënat personale të shkëmbyera nga Palët duhet të mbrohen me anë të masave teknike dhe organizative. Dispozitat</p>
--	---

	<p>që rregullojnë furnizimin e të dhënave personale janë përcaktuar në Seksionin E;</p> <ol style="list-style-type: none"><li>(2) Informacioni mund të shkëmbehet gjatë takimeve të rregullta, të lehtësuara nga EULEX-i në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij;</li><li>(3) Një kërkesë me gojë do pranohet vetëm në rast të një emergjence dhe me kusht që kërkesa dhe përgjigjja përkatëse janë regjistruar në të shkurtër në ditar të veçantë dhe është konfirmuar me shkrim brenda 24 orëve pasi është bërë kërkesa me gojë;</li><li>(4) Pala kërkuese duhet të shpjegojë qëllimin e kërkesës dhe se si do të përdoret informacioni;</li><li>(5) Të gjitha kërkesat dhe përgjigjet do të regjistrohen dhe arkivohen në mënyrën e duhur nga secila Palë;</li><li>(6) Çdo komunikim i shkruar duhet të kryhet në serbisht, shqip / shqip, serbisht, dhe/ose anglisht.</li></ol> <p><b>D) Përpunimi dhe përdorimin e informacionit dhe të dhënave të tjera të shkëmbyera</b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>(1) Të gjitha informatat e përpunuara, përdorura dhe shkëmbyera duhet të përdoren nga Palët vetëm për qëllimet e përcaktuara në Seksionin A (Parimet themelore);</li><li>(2) Palët nuk do të vejnë ndonjë informacion të shkëmbyer në dispozicion të asnjë Pale të tretë, me përjashtim të rrethanave të përshkruara në Seksionin A;</li><li>(3) I gjithë informacioni i shkëmbyer përpunohet dhe përdoret nga secila Palë në përputhje të plotë me legjislacioni vendor përkatës dhe atë të BE-së për mbrojtjen e të dhënave;</li></ol> <p><b>E) Furnizimi i të dhënave personale nga Palët</b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>1) Me rastin e transmetimit të të dhënave personale nga Palët, të dhënat personale mund të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat është bërë kërkesa. Kur të dhënat personale transmetohen pa një kërkesë të veçantë, në momentin e/ose para transmetimit të të dhënave, duhet të tregohet qëllimi për të cilin të dhënat janë transmetuar, si dhe çdo kufizim në përdorimin, fshirjen apo shkatërrimin e tyre, duke përfshirë kufizimet e mundshme të qasjes në përgjithësi ose kushtet specifike. Kur lind nevoja për kufizime të tilla pas furnizimit, Palët do të informojnë njëri-tjetrin për kufizimet e tilla në një fazë të mëvonshme.</li><li>2) Palët duhet t'i përmbahen kushteve si në vijim për të gjitha transmetimet e të</li></ol>
--	---

	<p>dhënave personale:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) pas pranimit, Palët do të vendosin pa vonesë, kur është e mundur brenda tre muajve nga marrja, se dhe në çfarë mase të dhënat të cilat janë furnizuar janë të nevojshme për qëllimin për të cilin janë furnizuar;</li> <li>2) të dhënat nuk do t'i komunikohen nga Palët tek shtetet e treta ose organet tjera, përveç me pëlqimin paraprak të Palës tjetër;</li> <li>3) transmetimin tutje i të dhënave nga ana e marrësit të parë do të kufizohet për autoritetet kompetente të secilës Palë, siç përcaktohet në Seksionin G, neni (2), duhet të bëhet në të njëjtat kushte si ato që zbatohen për transmetimin fillestar;</li> <li>4) furnizimi duhet të jetë i domosdoshëm në raste të veçanta për qëllimin e specifikuar në seksionin A;</li> <li>5) të gjitha kushtet për përdorimin e të dhënave të specifikuara nga Palët duhet respektuar;</li> <li>6) kur të dhënat furnizohen në bazë të kërkesës, kërkesa për të dhënat duhet të specifikojë qëllimin dhe arsyen e kërkesës. Në rast të mos specifikimit të qëllimit apo arsyes në kërkesë, të dhënat nuk do të transmetohen;</li> <li>7) të dhënat mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë kërkuar;</li> <li>8) të dhënat duhet të korrigjohen dhe fshihen nga secila Palë nëse del se ato janë të gabuara, të pasakta, të pa azhurnuara ose duhej të mos transmetoheshin;</li> <li>9) të dhënat duhet të fshihen kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë transmetuar.</li> </ol> <p>10) Palët duhet të sigurojnë që të dhënat personale të marra nga Pala tjetër janë të mbrojtura me anë të masave teknike dhe organizative. Masa të tilla do të jenë të nevojshme vetëm kur përpjekja që ato përfshijnë është në përpjesëtim me objektivin për të cilin janë dizajnuar të arrijnë në aspektin e mbrojtjes, dhe do të jenë të dizajnuara që të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) refuzojnë qasjen e personave të paautorizuar në pajisjet e përpunimit të të dhënave që përdoren për përpunimin e të dhënave personale,</li> <li>2) parandalojnë leximin, kopjimin, modifikimin ose fshirjen e mediave të të dhënave,</li> <li>3) parandalojnë futjen e paautorizuar të të dhënave personale dhe inspektimin, modifikimin ose fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale të ruajtura,</li> <li>4) parandalojnë përdorimin e sistemeve të automatizuara të përpunimit të të dhënave nga ana e personave të paautorizuar duke përdorur pajisje të komunikimit të dhënave,</li> <li>5) sigurojnë që personat e autorizuar për përdorimin e sistemeve të automatizuara për përpunimin e të dhënave të kenë qasje vetëm në të dhënat personale të mbuluara nga autorizimi për qasje,</li> <li>6) sigurojnë që ka mundësi të verifikohet dhe të vendoset se te cilat organe të dhënat personale mund të transmetohen duke përdorur pajisjet e</li> </ol>
--	---

	<p>komunikimit të të dhënave,</p> <ol style="list-style-type: none"><li>7) sigurojnë se mund të verifikoj dhe vendos më vonë se cilat të dhënat personale janë futur në sistemet e automatizuara për përpunimin e të dhënave dhe kur dhe nga kush janë futur të dhënat personale,</li><li>8) parandalojnë leximin, kopjimin, modifikimin ose fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale gjatë transferimit të të dhënave personale, ose gjatë transportimit të mediave të të dhënave,</li><li>9) sigurojnë se sistemet e instaluar mund, në rast të ndërprerjes, të rikthehen menjëherë,</li><li>10) sigurojnë se funksionet e sistemit kryhen pa gabime, se paraqitja e defekteve në funksione raportohet menjëherë dhe se të dhënat e ruajtura personale nuk mund të korruptohen me anë të një mosfunksionimit të sistemit.</li></ol> <ol style="list-style-type: none"><li>11) Përveç informatave të tjera, të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike ose bindjet fetare apo të tjera, ose ato në lidhje me shëndetin dhe jetën seksuale, do të furnizohen vetëm në rastet absolutisht të nevojshme.</li><li>12) Të dhënat personale nuk do të furnizohen në rast se nivel adekuat i mbrojtjes së të dhënave nuk garantohet më tej.</li><li>13) Ku njëra prej Palëve vëren se të dhënat e transmetuara personale janë të pasakta, të pa përditësuara, ose nuk duhej transmetuar, ajo informon Palën tjetër menjëherë, pa vonesa. Ata duhet të kërkojnë konfirmim se të dhëna e tilla do të korrigjohen ose fshihen.</li><li>14) Palët do të mbajë regjistrin e të gjitha komunikimeve të të dhënave personale, dhe arsyeve të komunikimit sipas këtij neni.</li><li>15) Ruajtja e të dhënave personale të transmetuara nga Palët nuk mund të kalojë një periudhë më shumë se tre vjet. Çdo afat kohor fillon të kalkulohet në datën në të cilën ndodh ngjarja që çon në ruajtjen e atij dhënave. Në qoftë se përmes aplikimit të këtij paragrafi periudha totale për ruajtjen e të dhënave personale të transmetuara nga Palët tejkalon periudhën prej tre vitesh, nevoja për ruajtjen e vazhdueshme duhet të rishikohet çdo vit dhe ky rishikim duhet të dokumentohet.</li></ol> <p><b>F) Shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit konfidencial</b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>(1) Palët, të lehtësuar nga BE-ja, synojnë krijimin e procedurave për shkëmbimin e informacionit konfidencial;</li></ol> <p><b>G) Takimet në nivel lokal, rajonal dhe qendror</b></p>
--	---

- (1) Palët do të organizojnë takime të rregullta në të gjitha nivelet përkatëse (lokal, rajonal dhe qendror).
- (2) Takimet në nivel lokal, në "ZPP", do të mbahen të paktën një herë në javë, midis autoriteteve kompetente, në përputhje me kërkesat e autoriteteve Doganore, Policore, fitosanitar dhe veterinarë dhe shërbimeve të tjera të secilës palë në "PK" . Këto autoritetet kompetente do të bien dakord mbi Termat e tyre të Referencës;
- (3) Takimet në nivel rajonal do të mbahen të paktën një herë në muaj, në mes të zyrtarëve përkatëse përgjegjës për rajonin e "ZPP". Zyrtarët kompetente do të bien dakord mbi Termat e tyre të Referencës;
- (4) Takimet në nivel qendror do të mbahen të paktën dy herë në vit, mes udhëheqësve gjegjës të agjencive të të dyja Palëve. Udhëheqësit gjegjës të agjencive do të dakodohen për Termat e tyre të Referencës;
- (5) Vendtakimi i Palëve do të jetë me rotacion. Pala ftuese duhet të hartoj një regjistër zyrtar, i cili duhet të merr pëlqimin e Palës tjetër;
- (6) EULEX-i, në pajtim me kohëzgjatjen dhe mandatin e tij, do t'i lehtësoj të gjitha takimet në të tre nivelet atë lokal, rajonal dhe qendror.

#### **H) Zgjidhja e kontesteve**

- (1) Kontestet që dalin gjatë zbatimit të këtyre procedurave do të zgjidhen nga Palët, të ndërmjetësuar nga BE. Në rast të mos zgjidhjes së kontestit, atëherë kontesti do të adresohet nga GZ.

#### **I) Parimet përfundimtare**

- (1) Ky dokument është pjesë përbërëse e Protokollit Teknik.

#### **Shtojca A) Shablioni i kërkesës për shkëmbimin e informacionit**

	<b>I KUFIZUAR</b> <input type="checkbox"/>	
<b>Raporti informues</b>		
<b>Organizata dhe zyrtari</b>		<b>Data dhe koha e raportit</b>

Ref. e burimi të informacionit		Regjistri		
<b>Afati i fundit i kërkuar nga:</b>				
1				
<b>Raport</b>				
<b>Të dhënat e personit</b>		<b>D</b>		<b>B</b>
Përshkrimi i veprimit/incidentit				
<b>Veprimet e ndërmarra nga njësia raportuese</b>				
<b>Veprimet e kërkuara nga marrësi</b>				





**IV Lehtësimi i komunikimit**

Secila Palë duhet t'i ofrojë individualisht EULEX-it, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, me adresat përkatëse të postës elektronike (e-mail), numrat e faksit dhe numrat e telefonit për të siguruar një lehtësim normal të shkëmbimit të informacionit të trajtuar më lartë.

Çdo komunikim me shkrim do të realizohet në gjuhën serbe, shqipe dhe/apo angleze. Secila Palë, si dhe EULEX-i, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, duhet të regjistrojë dhe arkivojë siç duhet të gjitha kërkesat dhe përgjigjet.

**V Kopja rezervë (backup)****Adresat elektronike (Email)**

Të gjitha llogaritë në Outlook.com ruhen në Serverat për Kopje Rezervë (Backup) të Microsoft. Përveç kësaj ato duhet të ruhen/arkivohen edhe nga SITCEN. Më poshtë gjenden setin shtesë të llogarive të postës elektronike (email) të krijuara në serverët e Gmail.com

- **Emri:** Rudnica – Jainjë; **e-mail:** [Rudnica.Jainje@gmail.com](mailto:Rudnica.Jainje@gmail.com)
- **Emri:** Bërnjak – Tabalije; **e-mail:** [Bernjak.Tabalije@gmail.com](mailto:Bernjak.Tabalije@gmail.com)
- **Emri:** Merdarë – Merdare; **e-mail:** [Merdare.Merdare@gmail.com](mailto:Merdare.Merdare@gmail.com)
- **e-mail:** Konçulj – Dheu i Bardhë; **e-mail:** [Konculj-DheuiBardhe@gmail.com](mailto:Konculj-DheuiBardhe@gmail.com)

**Numrat e faksit**

Nëse dështon faksi "pranues" faksi "transmetuesi" ende pranon dokumente (dhe vice versa)

**Numrat e telefonit** (Zyra e BE për Lehtësimin e MIK, Zyra përgjegjëse)

Numrat fiks dhe mobil mbështesin njëri tjetrin.

**Prishtina ka ofruar kontakt detajet si në vijim:**

1. Jarinje/Rudnica	Policia.	Doganat
Tel.	038 5080 1640 +381 656834328	028/590-681
Fax.	038 5080 1637	
E-mail	<a href="mailto:Porta1@kosovopolice.com">Porta1@kosovopolice.com</a>	<a href="mailto:pkkjarinje@dogana-ks.org">pkkjarinje@dogana-ks.org</a>
2. Bërnjak/Tabanije		
Tel.	038 5080 1637 +381 656834331	028/590-681
Fax.	038 5080 1640	
E-mail.	<a href="mailto:Porta31@kosovopolice.com">Porta31@kosovopolice.com</a>	<a href="mailto:pkkbernjak@dogana-ks.org">pkkbernjak@dogana-ks.org</a>
3. Merdare		

	<p>Tel. 038 570 241. 038 571 610 +377 44 344 837</p> <p>Fax. 038 570 241</p> <p>E-mail. <a href="mailto:Porta3@kosovopolice.com">Porta3@kosovopolice.com</a> <a href="mailto:pkkmerdare@dogana-ks.org">pkkmerdare@dogana-ks.org</a></p> <p>4. Dheu i Bardhë/Konqul</p> <p>Tel. 0280 320 644. 0280 390 083 +377 44 244 041</p> <p>Fax. 0280 320 644</p> <p>E-mail. <a href="mailto:Dheuibardhe@kosovopolice.com">Dheuibardhe@kosovopolice.com</a> <a href="mailto:pkkdheuibardhe@dogana-ks.org">pkkdheuibardhe@dogana-ks.org</a></p> <p><b><u>Beogradi ka ofruar kontak detajet si në vijim:</u></b></p> <p>Telefoni +381113617855 +381113617870</p> <p>E-mail <a href="mailto:stabapkm@mup.gov.rs">stabapkm@mup.gov.rs</a></p> <p>Fax +381113617871</p>			
	Dakordimi i mënyrës së avancimit në lidhje me SEED	GZ	NA	E arritur më 4 dhjetor 2012
	<p>Palët kanë arritur marrëveshje për shkëmbimin e informatave lidhur me doganat në mënyrë elektronike përmes SEED në përputhje me praktikën e SEED. Ky shkëmbim do të filloj sa më shpejtë të jetë e mundur por jo më vonë se 31 dhjetor 2012, 7.59. Kjo marrëveshje është pa paragjykim ndaj diskutimeve të organizatave rajonale që po zhvillohen në nivel të Kryeministrave. Secila palë do të angazhohet njëanshëm vis-a-vis BE-së në zbatimin e kësaj në përputhje me atë që u përmend më lartë. Pas dakordimit të Palëve, çfarëdo shkëmbimi tjetër i informacionit për tregti do të kryhet përmes procedurave mbi shkëmbimin e informatave. Pala nga Prishtina ka theksuar se si kompromis ata nuk do të konsiderojnë që të zbatohet tërësisht Protokollit Teknik i MIK përderisa nuk kanë qasje të plotë në organizatat rajonale të lidhura me MIK siç janë MARRI dhe SELEC. GZ për MIK është pajtuar të këshillojë nivelin e lartë politik në adresimin e kësaj çështje.</p>			
<b>3.1.1.</b>	Themelimi i Grupeve Punuese Teknike (GPT)			
	Dakordimi i krijimit të Grupeve Punuese Teknike dhe kalendarin e takimeve të tyre	GZ	NA	Arritur më 05/06 nëntor 2012
	GPT-të takohen rregullisht. GZ i rishikon të gjeturat e tyre në mënyrë të vazhdueshme			
<b>3.3.1</b>	GZ, në pajtim me Palët, do të përcaktoj modelin e punës në ndërrime të Doganave dhe Policisë si dhe prezencën e shërbimeve Veterinare, Fitosanitare dhe Ndihmësve të tjera në 'PK/ZPP në përputhje me Nenin 19 të Protokollit Teknik. Modelet e punës në ndërrime do të harmonizohen ndërmjet Palëve me qëllim që të garantohet një rrjedhë			

	të pandërprerë të personave, automjeteve dhe mallrave në çdo PK/ZPP'. Procedimi/lëvizja e bagëtisë do të realizohet në PK/ZPP Merdare/Merdarë dhe Jainjë/Rudnice		
Marrëveshja për modelin e punës në ndërrim/harmonizimi i procedurave	GZ	NA	Arritur më 03/04 dhjetor 2012
<p>Sa i përket <u>Procedurave Policore</u>, Palët janë pajtuar se qëndrojnë mjaftueshëm mirë dhe se nuk kanë nevojë për harmonizim të mëtutjeshëm.</p> <p>Sa i përket <u>Procedurave Doganore</u>, Palët janë pajtuar se qëndrojnë mjaftueshëm mirë dhe se nuk kanë nevojë për harmonizim të mëtutjeshëm.</p> <p>Beogradi ka njoftuar se nga 17 Dhjetori 2012, shpeditëret tregtar nga Pala e Prishtinës do të kenë qasje në territorin e saj 24/7 dhe do të mund të zhdoganojnë mallrat e tyre në терминаlet doganore të Nishit dhe Vrajës në çdo kohë ndërmjet orës 08:00 deri 20:00. Kjo korrespondon me sistemin në vend në anën e Palës së Prishtinës, ku shpeditëret tregtar nga Pala e Beogradit po ashtu kanë qasje 24/7 t'i zhdoganojnë mallrat e tyre në терминаlet në Mitrovicë, Podujevë dhe Konçul në çdo kohë ndërmjet orës 08:00 dhe 20:00.</p> <p>Sa i përket <u>Procedurave të shërbimeve të Veterinës dhe ato Fitosanitare</u>, Palët kanë pranuar që me vendosjen e këtyre shërbimeve, ata nuk do të kenë nevojë më për harmonizim. Palët janë pajtuar që BE të inicioj diskutimet mbi çështjet e pazgjidhura sa i përket tregtisë në këtë zonë, duke respektuar parimet si në vijim: (i) aplikohen procedurat për shkëmbim të informatave (ii) aplikohet marrëveshja për vula doganore (iii) aplikohen kërkesat/kushtëzimet e BE-së në këtë fushë.</p> <p>BE-ja do të thërret një takim mbi çështjet e rëndësishme në lidhje me tregtinë e lidhur me veterinarinë dhe fitosanitarinë më 17 dhjetor.</p> <p>Palët kanë informuar njëri tjetrin për <u>prezencën e tyre të parashikuar për ndërrimin 12 orësh</u> :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Jarinjë: Prishtinë: 15 Policë dhe 5 Doganierë, Beograd: 12 Policë dhe 6 Doganierë</li> <li>○ Bërnjak: Prishtinë: 8 Policë dhe 4 Doganierë, Beograd: 6 Policë dhe 6 Doganierë</li> <li>○ Merdare: Prishtinë: 13 Policë dhe 5 Doganierë, Beograd: 7 Policë dhe 6 Doganierë</li> </ul>			

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Koncul: Prishtinë: 13 Policë dhe 4 Doganierë, Beograd: 12 Policë dhe 6 Doganierë</li> <li>○ Palët janë pajtuar që bazuar në vlerësimet e nevojave, çoftë të rrisin apo zvogëlojnë prezencën në përputhje me kërkesat dhe do ta informojnë njëri tjetrin sipas rrethanave. Qëllimi i përgjithshëm është garantimi i prezencës së barabartë në të gjitha rrethanat.</li> <li>○ Prishtina ka informuar për prezencën e EULEX-it e cila do të jetë 49%, kurse prezenca e Prishtinës do të jetë 51-% në Bërnjak dhe Jarinjë dhe më e lartë në Konçul dhe Merdare.</li> </ul>				
<b>3.3.2</b>	‘PK/ZPP do të operoj 24/7. Palët do ta informojnë njëra tjetrën për procedurat përkatëse sa i përket procedimit të personave, automjeteve dhe mallrave. GZ do të bën përpjekje të paraqes procedura dhe procese plotësuese për kontrollin dhe identifikimin e personave, automjeteve dhe mallrave në përputhje me parimet e MIK me qëllim të lehtësimit të qarkullimit dhe tregtisë legjitime.				
	<table border="1"> <tr> <td>Marrëveshja sipas 3.3.1</td> <td>GZ</td> <td>NA</td> <td>Shih 3.3.1</td> </tr> </table>	Marrëveshja sipas 3.3.1	GZ	NA	Shih 3.3.1
Marrëveshja sipas 3.3.1	GZ	NA	Shih 3.3.1		
	Marrëveshja e arritur sipas 3.3.1				
<b>3.3.3</b>	GZ do të jetë përgjegjës për të siguruar se kontrolli i trafikut po zhvillohet me lehtësi në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara, të shkaktuara nga nivelet e pazakonta dhe rritja e fluksit të trafikut. Në raste të tilla, autoritetet kompetente të secilës Palë do të ndërmarrin masa përkatëse dhe të zbatueshme të kontrollit për të lehtësuar fluksin e madh të trafikut. Masa të tilla të lehtësimit të kontrollit do të merren vetëm në baza të përkohshme. GZ duhet të gjej zgjidhje dhe bie dakord me detajet e mëtejshme që objekt i rrethanave sipas kërkesave.				
	<table border="1"> <tr> <td>Marrëveshja mbi kontrollet e lehtësuara</td> <td>GZ</td> <td>NA</td> <td>Arritur më 20 Nëntor 2012</td> </tr> </table>	Marrëveshja mbi kontrollet e lehtësuara	GZ	NA	Arritur më 20 Nëntor 2012
Marrëveshja mbi kontrollet e lehtësuara	GZ	NA	Arritur më 20 Nëntor 2012		
	<p style="text-align: center;"><b>Kontrollet e lehtësuara</b></p> <p>(1) Në përputhje me Protokollin Teknik të MIK, Seksioni D, pika 29, dhe në përputhje me Rregulloren e BE-së nr. 562/2006, neni 8, secila palë mund t'i relaksoj kontrollet në pikë-kalime për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara.</p> <p>(2) Rrethanat e tilla të jashtëzakonshme dhe/ose paparashikuara janë ngjarjet që çojnë në trafik me kaq intensitet kështu që koha e pritjes në pikë-kalimet bëhet e tepërt dhe e gjatë edhe pse të gjitha burimet potenciale (stafi, objektet dhe organizimi) janë përdorur.</p>				

	<p>(3) Relaksimi i kontrolleve është i përkohshëm, i futur në mënyrë graduale, i arsyetuar dhe duhet të korrespondoj me nevojat/rrethanat.</p> <p>(4) Vendimi për relaksim të kontrolleve merret nga zyrtari komandues.</p> <p>(5) Në rast se zbatohen kontrollet e tilla lehtësuese, autoritetet përkatëse janë të obliguar të aplikojnë masat minimale të kontrollit që duhet të përfshijnë identifikimin dhe kontrollimin e besueshëm të vlefshmërisë së dokumenteve të personave. Kur vendosen qëllimet prioritare, kontrolli në hyrje duhet të jetë me prioritet përkundër atij në dalje.</p> <p>(6) Edhe pse në parim në diskrecionin e secilës palë, për hir të funksionimit normal të PK/ZPP, Palët, të lehtësuara nga BE-ja, kanë për qëllim kontrollet e lehtësuara të sinkronizuara dhe korresponduese.</p> <p>(7) Në rast se njëra palë gjykon rrethanat në PK/ZPP duke kërkuar aplikimin e kontrolleve të lehtësuara, ajo, me ndihmën e BE-së, kontakton palën tjetër kështu që diskutimet për këtë zhvillohen menjëherë.</p>			
<b>3.3.4</b>	Duke marrë parasysh modelin e dizajnit sipas marrëveshjes për PK/ZPP të përmendur në 3.1.2, Palët përmes GZ dhe të lehtësuara nga BE-ja do të sigurojnë që të gjitha 'ZPP-të' përfshijnë pjesë të rrugës, objekteve, objektet ndihmëse, të tilla si tualetet, rrethojat dhe ndriçimi, dhe çdo hapësirë tjetër ose objekt të nevojshme për zbatimin e kontrolleve / procedurave përkatëse nga autoritetet përkatëse kompetente.			
	Marrëveshja për hartimin e pikë-kalimeve të përbashkëta 'të përkohshme'	GZ		Arritur gjatë vizitave në terren në nëntor
	Planet përfundimtare janë në posedim të të gjitha Palëve me përjashtim të planit / draftit për Dheun e Bardhë / Konqul e cila ende kërkon miratimin përfundimtar me 12/13 dhjetor në GZ. Këto plane përfundimtare / drafte të të gjitha pikë-kalimeve të përbashkëta "të përkohshme" janë pjesë përbërëse e këtij plani të veprimit. Planet/draftet origjinale janë në posedim të BE-së.			
<b>Çështjet e tjera</b>	Pika të ndryshme të ngritura			
<b>1</b>	Aranzhimi Teknik për operimin e 'Pikë-kalimeve të përbashkëta të përkohshme të MIK'			
	Marrëveshja mbi Aranzhimin Teknik	GZ	NA	Arritur më 04 dhjetor 2012
	Marrëveshja Teknike për operimin e Pikë-kalimeve të përbashkëta të përkohshme të MIK (PK)/zona e përbashkët e MIK (ZPP) <sup>2</sup> me 23 shkurt 2012 Protokollin Teknik për zbatimin e MIK 'konkluzionet e arritura të Dialogut të 2 Dhjetor 2011			
	<p><b><u>Neni 1</u></b> Qëllimi i kësaj Marrëveshje Teknike për operimin e Pikë-kalimeve të përbashkëta të</p>			

<sup>2</sup>Njëra palë e nje vijën si kufi; pala tjetër e nje vijën si kufi administrativ.

përkohshme (më tej referuar si 'PK')/Zona e Përkohshme të Përbashkët e MIK (më tej referuar si 'ZPP') më tej sqaron detyrat dhe përgjegjësitë e palëve në lidhje me vendosjen e personelit në PK/ZPP dhe sqarimin e funksioneve dhe garanton vendosjen e personelit të palëve dhe EULEX-it, në përputhje me, dhe kohëzgjatjen e mandatit të tij, në PK/ZPP.

Në fazë të mëvonshme, Palët do të krijojnë pikë-kalime kufitare permanente të MIK/ Zona të përbashkëta permanente të MIK.

Në përputhje me konkluzionet e arritura të MIK, me Traktatin e Lisbonës, dhe legjislacionin përkatës të BE-së dhe duke pasur parasysh që të dy palët janë pjesë të agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, atyre do t'u kërkohet që në mënyrë graduale të harmonizojnë legjislacionin e tyre me atë të acquis të BE-së dhe në veçanti do t'u kërkohet të aplikojnë konceptin e MIK siç është përcaktuar në Konkluzionet e Këshillit të datës 4-5 Dhjetor 2006.

### **Neni 2**

Duke vepruar në mirëbesim, Palët janë pajtuar të themelojnë dhe fillojnë operimin e PK/ZPP Jarinjë/Rudnice, Tabavije/Bërnjak, Dheu i Bardhë/Konqul, Merdare/Merdarë, Mutivodë/Mutivode dhe Depce/Muçibabë.

Palët janë pajtuar të themelojnë PK/ZPP në Jarinjë/Rudnice, Dheu i Bardhë /Konqul, Tabavije /Bërnjak, dhe Merdare /Merdarë- dhe të fillojnë funksionimin më datën 10 dhjetor 2012, 08.00 më së largu, përveç nëse palët pajtohen ndryshe. Themelimi dhe funksionimi i PK/ZPP në Mutivodë /Mutivode dhe Depce /Muçibabë do të fillon në një fazë më të vonshme.

Palët janë pajtuar që tre PK/ZPP do të vendosen në territorin e njëjës dhe tre në territorin e tjetrës palë. Palët janë pajtuar të themelojnë dhe vënë në funksion PK/ZPP Jarinjë/Rudnice dhe Dheu i Bardhë /Konqul në territorin e komunës së Rashkës dhe Bujanovcit.

PK/ZPP Tabavije /Bërnjak dhe Merdare /Merdarë në territorin e Kosovës. Palët pajtohen për vendosjen dhe funksionimin e mëvonshëm të PK/ZPP në Mutivodë /Mutivode në territorin e Kosovës dhe PK/ZPP Depce /Muçibabë në territorin e Komunës së Preshevës.

### **Neni 3**

PK/ZPP do të akomodojnë një prezencë të barabartë të të gjitha autoriteteve kompetente, në përputhje me kërkesat, siç janë Doganat, Policia, Fitosanitaria dhe Veterinaria, shërbimet ndihmëse dhe tjera të secilës Palë. Autoritetet kompetente të secilës palë do të kryejnë kontrole ndaras prej njëri tjetrit brenda pjesës së tyre të ZPP në pajtim me përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre gjegjëse ligjore të aplikueshme nën juridiksionin e saj gjegjës, me respekt të plotë për të drejtat e njeriut të garantuara me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

### **Neni 4**

Të dy palët e pranojnë që EULEX-i, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, do të jetë prezent në të gjitha PK /ZPP e garantuar me këtë marrëveshje.

**Neni 5**

Pala akomoduese në marrëveshje me Palën tjetër do t'i bëj rregullimet e nevojshme për ofrimin e lokacioneve për vendosjen e objekteve dhe infrastrukturës së përkohshme të nevojshme të PK për prezencë të barabartë të autoriteteve kompetente, siç janë Doganat, Policia, Fitosanitaria dhe Veterinaria, shërbimet ndihmëse dhe të tjera (të përshkruar në Nenin 3 të kësaj Marrëveshje Teknike), në territorin e tyre gjegjëse, sipas Nenit 2, në përputhje me kërkesat operationale të autoriteteve kompetente të secilës palë për kryerjen e kontroleve në pajtim me përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre gjegjëse ligjore të aplikueshme.

**Neni 6**

Projektimi i secilës PK/ZPP do të ndjek modelin e projektimit të PK/ZPP të dakorduar nga palët, e cila do t'i përshtatet kërkesave/nevojave/trafikut/terrenit për/ secilën PK/ZPP.

ZPP-të do të përfshijnë por nuk do të kufizohen vetëm në pjesët e rrugës, objektet, objektet ndihmëse, siç janë tualetet, rrethojat dhe ndriçimi, dhe çfarëdo hapësire ose objekt tjetër i nevojshëm për zbatimin e kontroleve/procedurave përkatëse nga autoritetet kompetente gjegjëse.

Të dy palët do të jenë përgjegjëse dhe do t'u lejohet të instalojnë, mirëmbajnë dhe vënë në funksion çfarëdo pajisje zyrtare dhe ato të telekomunikimit (që do të bëhen në pajtim me standardet ndërkombëtare me qëllim të evitimit të ndërhyrjeve të mundshme), që duhet të përdoren në mënyrë ekskluzive nga zyrtarët e tyre gjegjës për kryerjen e detyrave të tyre. Të dy palët e pranojnë dhe pajtohen që EULEX-it, në përputhje me, dhe kohëzgjatjen e mandatit të tij, i lejohet të instaloj, mirëmbaj dhe vëj në funksion pajisjet zyrtare dhe të telekomunikimit për kryerjen e detyrave të tyre.

Mirëmbajtja përfshirë shërbimet siç janë, por nuk kufizohen në, ujin, rrymën, grumbullimin e mbeturinave që do të ofrohen nga pala akomoduese në territorin e të cilit PK/ZPP gjegjëse është vendosur. Pala akomoduese do të mbuloj shpenzimet për operimin/mirëmbajtjen e PK/ZPP në territorin e saj.

Pala akomoduese është përgjegjëse për sigurinë e të gjithë zyrtarëve të vendosur në PK/ZPP në territoret e tyre gjegjëse. Pala akomoduese është po ashtu përgjegjëse për sigurinë e zyrtarëve nga pala tjetër. Planifikimi dhe zbatimi i masave përkatëse të sigurisë do të kryhet në përputhje me standardet e BE-së që u janë dorëzuar palëve nga BE-ja.

**Neni 7**

Sa i përket kryerjes së detyrave zyrtare në PK/ZPP, zbatohet Pika 20 e Protokollit Teknik për Zbatimin e Konkluzioneve të Arritura për MIK. Të dy palët pajtohen që i gjithë personeli i EULEX-it i vendosur në PK/ZPP do të gëzoj të gjitha privilegjet dhe imunitetet diplomatike dhe merr përsipër të miratoj çdo legjislacion të nevojshëm për lehtësimin e kësaj me zbatim të menjëhershëm.

Dispozitat e mësipërme vlejné për zyrtarët gjatë udhëtimit prej dhe deri te vendi i tyre i punës nga territoret e tyre përmes territorit të palës tjetër. Dispozitat e mësipërme po ashtu vlejné edhe për zyrtarët e EULEX-it gjatë udhëtimit prej dhe deri te vendi i tyre



i punës në PK/ZPP.

Në përputhje me praktikat e krijuara dhe me Protokollin Teknik, nën-pika 26, veprimet e kryera nga zyrtarët e palëve gjatë rrugës për në dhe në PK/ZPP do të konsiderohen si të kryera në territorin gjegjës të palës në fjalë. Kur PK/ZPP është vendosur në territorin e njëres palë, rruga prapa palës së mirëpritur do të kontrollohet nga pala e mirëpritur për qëllime të kontrollit të MIK, si dhe për çfarëdo qëllimi tjetër. Sidoqoftë, në raste të qështjeve që nuk lidhen me MIK, pala e mirëpritur mund të ftohet nga pala mikëpritëse të ndërmerr veprime në përputhje me procedurat e saj gjegjëse. Në rastet kur personeli i EULEX-it kryen veprime në përputhje me mandatin e tij/saj, veprimet e tyre duhet të konsiderohen si të kryera në territorin e Kosovës. Çdo dokument apo pajisje zyrtare përfshirë por që nuk kufizohet në qenët nuhatës që i përkasin njësisë K9 nuk do ti nënshtrohen konfiskimit dhe/ose kërkimet nga zyrtarët e palës tjetër. Dokumentet dhe pajisjet zyrtare në posedim të personelit të EULEX-it, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij/saj, përfshirë por jo kufizuar në qenët nuhatës të njësisë K9 nuk do ti nënshtrohen konfiskimit dhe/ose kërkimet nga zyrtarët e secilës palë.

### **Neni 8**

ZPP/PK do të funksionon 24/7. Doganat, Policia, Fitosanitaria dhe Veterinaria, shërbimet ndihmëse dhe të tjera, sipas nevojës, do të funksionojnë në të gjitha PK/ZPP në një model të ndërrimeve prej 12 orëve (Fitosanitaria dhe Veterinaria vetëm gjatë orëve të ditës), e cila do të harmonizohet ndërmjet palëve me qëllim të garantimit të rrjedhës së pandërprerë të personave, veturave dhe mallrave në PK/ZPP. Të dyja Palët pranojnë se EULEX-i, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, mund të veprojnë në PK/ZPP në ushtrimin e mandatit të tij. Përpunimi / lëvizja e produkteve të bagëtisë, bimëve dhe kafshëve do të kryhet në PK/ZPP Merdare / Merdarë dhe Jarinjë / Rudnicë. Shërbimet Veterinare dhe fitosanitare do të veprojnë në kuadër të terminaleve të brendshme me një model të zakonshme të ndërrimeve prej dymbëdhjetë (12) orëve gjatë ditës, të cilat do të harmonizohen ndërmjet Palëve për të siguruar një rrjedhë të pandërprerë të personave, automjeteve dhe mallrave nëpër PK/ ZPP. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për procedurat e tyre përkatëse për regjistrimin e personave, automjeteve dhe mallrave dhe për çdo ndryshim të tyre. Palët do të ndërmarrin hapa për të paraqitur procedura dhe proceset plotësuese për kontrollin dhe identifikimin e personave, automjeteve dhe mallrave në përputhje me parimet e MIK në mënyrë që të lehtësojë trafikun dhe tregtinë legjitime.

### **Neni 9**

Zyrtarët nga secila Palë, që hyjnë apo dalin dhe gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare në zonën e tyre të ZPP duhet të kenë uniformat dhe shenjat e tyre zyrtare të identifikimit.

Përyjashtimisht, dhe kufizuar në ZPP, Palët nuk do të shfaqin simbolet e juridiksioneve të tyre gjegjëse. Të dyja Palët pranojnë se personeli i EULEX-it, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, mund të mbajnë çdo uniformë dhe simbole sipas marrëveshjeve dhe udhëzimeve të tyre të brendshme.

Zyrtarët nga cilado Palë do të mbajnë kartën e identitetit dhe autorizimin zyrtar që i jep zyrtarit të drejtë të hyjnë dhe të punojnë në pjesën e tyre të ZPP. Kartat e identitetit

duhet të jetë e lëshuar nga autoriteti kompetent i secilës palë. Çdo Palë njofton tjetrën se cilat karta të identitetit janë të vlefshme për të hyrë / dal nga ZPP. Të dyja palët e pranojnë se personeli i EULEX-it, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, të vendosur në PK / ZPP do të mbajnë kartat e identitetit zyrtare të EULEX-it. Informacioni funksional në ZPP do të shfaqet në gjuhët zyrtare. Përveç kësaj, tekstet do të shfaqen në gjuhën angleze.

### **Neni 10**

Në pjesën e saj të ZPP përdorimi i forcës dhe masave të tjera të zbatimit të ligjit nga çdo Palë rregullohet nga legjislacioni përkatës. Të dyja Palët pranojnë se EULEX-i, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, personeli në PK / ZPP do të ushtrojë funksionet e tij, të cilat mund të përfshijnë përdorimin e forcës në përputhje me rregullat që qeverisin përdorimin e forcës nga EULEX-i, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, personeli në territorin e Kosovës, përfshirë edhe kërkesat e ligjeve dhe instrumenteve përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Zyrtarët e të dy palëve do të lejohen të posedojnë, të mbajnë dhe të përdorin çfarëdo armë të zjarrit dhe pajisje të tjera të autorizuar nga legjislacioni i tyre përkatës në fuqi. Të dyja palët pranojnë dhe pajtohen që personeli i EULEX-it, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, të vendosur në PK/ZPP do të lejohen të posedojnë, të mbajnë dhe të përdorin armën e zjarrit dhe pajisjet autorizuar nga EULEX-i.

### **Neni 11**

Brenda ZPP, pasi të bëhet regjistrimi i personave, automjeteve dhe mallrave nga ana e zyrtarëve nga territori i daljes, ata/ato do të vazhdojnë më tutje ku do të regjistrohen nga zyrtarët nga territori i hyrjes. Pas largimit nga territori i daljes në kuadër të ZPP, personat, automjetet dhe mallrat nuk mund të regjistrohen më nga zyrtari nga territori i daljes përveç nëse u refuzohet hyrja nga ana e zyrtarëve nga territori i hyrjes. Personat dhe mallrat që u ndalohej hyrja në territorin e hyrjes duhet të kthehen në territorin e daljes. Megjithatë, çdo Palë duhet të veproj në përputhje me legjislacionin e tij në lidhje me azilin dhe migracionin.

### **Neni 12**

Siç është rënë dakord nga Palët, kontrollet e lehtësuara të trafikut mund të vendosen në rast të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara, të shkaktuara nga nivelet e pazakonta dhe rritja e flukseve të trafikut. Masa të tilla të lehtësimit të kontrollit do të vendosen vetëm në baza të përkohshme.

Siç është rënë dakord nga palët, planet e emergjencës do të shërbejnë për ndodhitë e paparashikueshme dhe / ose të paparapara. Në raste të tilla, Palët, sipas kërkesës, do t'i sigurojnë njëri-tjetrit ndihmë të ndërsjellë.

### **Neni 13**

Palët bien dakord për mekanizmat për qëllime të shkëmbimit të informacionit dhe të dhëna të tjera nga fushat të cilat janë ose mund të jenë me rëndësi për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve kriminale, si dhe për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe sigurinë e ushqimit në zonat e tyre përkatëse të përgjegjësive, duke përfshirë shkëmbimin e statistikave të lëvizjes së

	<p>personave dhe mallrave, si dhe paligjshmërisë së zbuluar. Palët kanë rënë dakord për mekanizmat për shkëmbimin, përpunimin dhe përdorimin e informacioneve në mes tyre. Asnjëra Palë nuk do të përdorë informacion dhe të dhëna tjera të ofruara nga pala tjetër për çështje të tjera përveç atyre të përshkruara nga aneksi për shkëmbimin, përpunimin dhe përdorimin e informacionit dhe nuk do të jep informatat e tilla ndonjë palë tjetër përveç për organet e tjera relevante të BE-së. I gjithë përpunimi i informacionit do të kryhet në përputhje të plotë me standardet e BE-së për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave.</p> <p><b><u>Neni 14</u></b></p> <p>Për ndonjë shkelje apo vepër penale, si dhe për çdo detyrim dhe dëm në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare në ZPP, Pala që ka caktuar zyrtarin që ka kryer veprimin e tillë do të jetë përgjegjëse dhe do të aplikohet legjislacioni i Palës përkatëse / autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit janë përgjegjëse. Të dy Palët pranojnë privilegjet dhe imunitetet që i gëzon personeli i EULEX-it, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, siç është përcaktuar në nenin 7 të kësaj marrëveshje teknike.</p> <p><b><u>Neni 15</u></b></p> <p>Data e fillimit të këtij Protokollit Teknik është 10 dhjetor 2012, 08.00 përveç nëse vendoset ndryshe nga Palët.</p> <p>Ndryshimet në këtë protokoll teknik do të bëhen në pajtim me Palët, pas konsultimeve me shkrim me BE-në.</p> <p>Pas konsultimeve me BE-në, secila palë është e lirë të anuloj këtë Protokoll Teknik nëpërmjet njoftimit me shkrim të palëve në këtë protokoll dhe EULEX-in. Anulimi i këtij Protokollit Teknik do të hyjë në fuqi 12 muaj pas një njoftimi të tillë.</p> <p><b><u>Neni 16</u></b></p> <p>Kjo marrëveshje teknike nuk do të ndryshojë mandatin e KFOR-it. COMKFOR-i do të mbahet i informuar për zbatimin e marrëveshjes, në veçanti, ato detaje të cilat mund të ndikojnë në misionin e KFOR-it. Kërkesat për ndihmë të KFOR-it do të bëhen nga ShiM të EULEX-it, në përputhje me, dhe për kohëzgjatjen e mandatit të tij, tek COMKFOR-i. Në përputhje me Marrëveshjen Teknike Ushtarake (MTU), pëlqimi i COMKFOR-it duhet të kërkohet për praninë e policisë serbe apo personelit të armatosur brenda KA.</p> <p>Në margjinat e diskutimeve mbi marrëveshjen teknike, palët u informuan në detaje nga CPCC në përpjekjet e saj për të lidhur një marrëveshje mes BE-së dhe Beogradit ekskluzivisht për personelin e EULEX-it për P&amp;I që vepron atje. Palët nuk kanë shprehur kundërshtime/shqetësime.</p>			
2	Planet e Sigurisë/Emergjencave			
	Marrëveshja për planet e emergjencave	GZ	NA	Marrëveshja e arritur më 04

				Dhjetor 2012
	Palët kanë zhvilluar plane të detajuara të emergjencave. Palët kanë vendosur parimet e lidhura me sigurinë/emergjencat, të cilat ata do t'i përfshijnë në planet e tyre përkatëse të Sigurisë/emergjencave me datën, 6 dhjetor 2012, e Enjte 18:00 dhe do ta paraqesin tek kryesuesi i GZ. Pasi të jetë paraqitur, këto plane të emergjencave do të jenë pjesë përbërëse e këtij Plani Veprimi			
3	Ndihma juridike e ndërsjellë			
	Dakordimi mbi Marrëveshjen teknike	GZ	NA	Mënyra e përparimit e dakorduar me 04 dhjetor 2012
	Palët janë pajtuar të vazdhojnë më tej diskutimi mbi ndihmë juridike të ndërsjellë, bazuar në tekstin e dorëzuar tek Palët nga BE-ja, me datë 12/13 Dhjetor 2012 in Bruksel, ku do të marrin pjesë të gjitha autoritetet relevante.			